REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 766/20
Datë/Datum. 29.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.766/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: D.P.Z Auto-Ngjyrosës "Eclips" - Ferizaj, kundër njoftimit për dhënie të kontratës), ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatorëve ekonomik "Dashnimi" SH.P.K – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve komunale" me nr. të prok: 656-20-4253-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "KK-Ferizaj", më datën: 28.10.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: D.P.Z Auto-Ngjyrosës "Eclips" - Ferizaj, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin prokurimit me titull: "Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve komunale" me nr. të prok: 656-20-4253-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "KK-Ferizaj".

II. **ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve komunale" me nr. të prok: 656-20-4253-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "KK-Ferizaj" (KK.F), dhe lënda të kthehet në **rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: D.P.Z Auto-Ngjyrosës "Eclips" - Ferizaj, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues D.P.Z Auto-Ngjyrosës "Eclips" - Ferizaj, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 05.10.2020 me nr. 766/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatorëve ekonomik "Dashnimi" SH.P.K – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve komunale" me nr. të prok: 656-20-4253-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "KK-Ferizaj" (KK.F), duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 7, 59, si dhe nenin 10 të LPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 07.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 13.10.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE-ankues sqaron si në vijim:
Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues D.P.Z Auto Ngjyrosës "Eclips" - Ferizaj
Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:
Sqarimi hyrës:
Pretendimet ankimore te OE ankues kanë te bëjnë kundër vendimit te ZPP për mos futur ne gare për vlerësim, ekzaminim dhe krahasim te tenderëve ne këtë aktivitet te prokurimit. Njoftimi për kontratë është publikuar 10.08.2020.
Procesverbali i hapjes është bere me date 31.08.2020. Vendimi i ZPP për ta përjashtuar nga gara OE ankues është marr me date 10.09.2020.
Përgjigje në Pretendimi nr. 1
Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 1, 7 dhe 10 te LPP-se, duke mos vlerësuar dosjen tone fare duke u thirre ne Vendimin nga udhëheqësi i zyrës qe oferta

juaj te mos merret për baze për tu vlerësuar pasi qe ju si OE ne vitin 2019 keni bere shkelje te kontratës te cilën e keni pasur me komunën e Ferizajt!

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, duke marr për baze raportin komisioni i vlerësimit e vlerësimit të datës 31.08.2020 (nënshkruar na komisioni dhe aprovuar nga ZPP me date 02.09.2020), letrën standarde te eliminimit te datës 02.09.2020 për OE ankues, nuk është arsyetuar pse tenderit i OE ankues nuk është vlerësuar duke jap këtë arsyetim, ku thotë: OE DPZ AUTO- NGJYROSES "ECLIPS" nga vendimi i udhëheqësit të zyrës se prokurimit të dt. 10.09.2020 ky OE nuk futet ne garë pasi qe ne vitin 2019 ka pasur ndërprerje te kontratës te lidhur me komunën e Ferizajt për arsye te shkeljes se kontratës!", gjithashtu ZPP ne Vendimin e datës 29.09.2020, refuzohet e krekës për rishqyrtim e OE ankues nuk ka dhënë asnjë arsyetim të bazuar në ndonjë dispozite ligjore te LPP-se, tek arsyetimi, ku thotë: "Pas shqyrtimit te kërkese për rishqyrtim nga ana juaj, ne si autoriteti kontraktues konstatojmë se kërkesa juaj ankimor është e pabazuar" prandaj duke analizuar këto dokumente, AK nuk e ka respektuar nenin 54 par. 1.1 të LPP-së, po citoj: "në rast të eliminimit të kandidatit, njoftimi do të shpjegojë arsyet për refuzimin e kërkesës për pjesëmarrje të atij kandidati", nenin 1 par. 1 te LPP-se, po citoj: "Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë ", nuk ka vepruar ne pajtim me nenin 1 par. 2 te LPP-se, po citoj: "Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji", nenin 7 paragrafi 1 të LPP-së, po citoj: "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente", nenin 10 par. 3 te LPP-së, po citoj: "Me kërkesën me shkrim nga cilado palë e interesit, autoriteti kontraktues i siguron qasje të arsyeshme palës që kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, përveç informatave sekrete afariste të cilat vërtetohen si të tilla nga një autoritet përkatës që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyllur', prandaj AK - komisioni i vlerësimit ka qenë i obliguar te respektojnë te gjithë këto nene si me lart dhe te veproj ne harmoni me te gjitha dispozitat ligjore te LPP-se, ta vlerësoj, ekzaminoj dhe krahasoje tenderin e OE ankues pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit, sikurse te gjithë pjesëmarrësit tjerë ne këtë procedure te

prokurimit. Duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këto pika janë te qëndrueshëm.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparent dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Mendimi i ekspertes shqyrtuese:

Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura dhe te gjeturat tjera ne këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues, të aprovohet si e bazuar, dhe rekomandon të anulohet B58-njoftimit mbi vendimin AK (rekomandimi për dhënie të kontratës) dhe lënda të kthehet **në Ri-vlerësim.**

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 13.10.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues me datë: 14.10.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik me datë: 16.10.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 28.10.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues D.P.Z Auto-Ngjyrosës "Eclips" – Ferizaj, se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 1, 7 dhe 10 t ë LPP-s ë, duke mos vlerësuar dosjen ton ë fare duke u thirr n ë Vendimin nga udhëheqësi i zyrës q ë oferta juaj t ë mos merret për bazë për tu vlerësuar pasi q ë ju si OE n ë vitin 2019 keni bërë shkelje t ë kontratës t ë cilën e keni pasur me komunën e Ferizajt.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se duke marr për bazë raportin e komisionit t ë vlerësimit të datës 31.08.2020 (nënshkruar nga komisioni dhe aprovuar nga ZPP me datë 02.09.2020), letrën

standarde t ë eliminimit t ë datës 02.09.2020 për OE ankues, nuk është arsyetuar pse tenderit i OE ankues nuk është vlerësuar duke jap këtë arsyetim, ku thuhet: OE DPZ AUTO- NGJYROSES "ECLIPS" nga vendimi i udhëheqësit të zyrës se prokurimit të dt. 10.09.2020 ky OE nuk futet n ë garë pasi q ë n ë vitin 2019 ka pasur ndërprerje t ë kontratës t ë lidhur me komunën e Ferizajt për arsye t ë shkeljes s ë kontratës". Gjithashtu, ZPP n ë vendimin e datës 29.09.2020, refuzohet k ërkesa për rishqyrtim e OE ankues nuk ka dhënë asnjë arsyetim të bazuar në ndonjë dispozit ë ligjore t ë LPP-së, tek arsyetimi, ku thotë: "Pas shqyrtimit t ë kërkes ës për rishqyrtim nga ana juaj, ne si autoriteti kontraktues konstatojmë se kërkesa juaj ankimore është e pabazuar". Andaj, në bazë të këtyre dokumenteve, AK nuk e ka respektuar nenin 54 par. 1.1 të LPP-së, ku thuhet: "në rast të eliminimit të kandidatit, njoftimi do të shpjegojë arsyet për refuzimin e kërkesës për pjesëmarrje të atij kandidati", nenin 1 par. 1 te LPP-se, po citoj: "Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë ", Po ashtu, nuk ka vepruar n ë pajtim me nenin 1 par. 2 t ë LPP-s ë, ku thuhet: "Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji", pastaj nuk ka respektuar nenin 7 paragrafi 1 të LPP-së, ku thuhet: "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente", nenin 10 par. 3 t ë LPP-së, ku thuhet: "Me kërkesën me shkrim nga cilado palë e interesit, autoriteti kontraktues i siguron qasje të arsyeshme palës që kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, përveç informatave sekrete afariste të cilat vërtetohen si të tilla nga një autoritet përkatës që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyllur'.
Pra, AK ka qenë i obliguar t ë respektojnë t ë gjitha dispozitat ligjore t ë cekura si m ë lart dhe t ë veproj n ë harmoni me te gjitha dispozitat ligjore t ë LPP-s ë, t ë vlerësoj, ekzaminoj dhe krahasoj tenderin e OE ankues pjesëmarrës n ë këtë aktivitet t ë prokurimit, sikurse t ë gjithë pjesëmarrësit tjerë n ë këtë procedurë të prokurimit.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit t ë shkresave t ë l ënd ës dhe sqarimeve t ë ekspertit shqyrtues, vjen n ë p ërfundim se AK nuk ka vepruar n ë harmoni me dispozitat ligjore t ë cekura me lartë gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tender ëve. Andaj, obligohet AK që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve n ë harmoni me nenin 59 t ë LPP-së, si dhe konform këkresave të dosjes s ë tenderit. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktues janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë

qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparent dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi Paçarizi

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "KK-Ferizaj" (KK.F),

1x1 OE D.P.Z Auto-Ngjyrosës"Eclips" - Ferizaj,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.